REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 938-945/20
Data/Datum 11.01.21
PAVARTAKË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.938/20
945/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenkovic - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik "Arhiko Ing O.P; & Al-Group" SH.P.K-Prishtinë, dhe grupi i OE "Taulant" SH.P.K; & "Studio Hapsira" SH.P.K-Prishtinë, kundër B58-njoftimim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë OE "Eng Idea" SH.P.K-Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime të projektimit dhe dizajnimit të projekteve të infrastrukturës për nevojat e FSK-së dhe MM-së" , me nr. të prok: 217-20-4418-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria e Mbrojtjes" , më datën: 11.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. <u>APROVOHET</u>, pjesërisht si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik "Arhiko Ing O.P & Al-Group" SH.P.K-Prishtinë dhe ankesa e grupit të operatorëve ekonomik "Taulant" SH.P.K. & "Studio Hapsira" SH.P.K-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime të projektimit dhe dizajnimit të projekteve të infrastrukturës për nevojat e FSK-së dhe MM-së" , me nr. të prok: 217-20-4418-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria e Mbrojtjes".

II. <u>VERTETOHET</u>, vendimi i Autoritetit Kontraktues, njoftimi mbi dhënien e kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime të projektimit dhe dizajnimit të projekteve të infrastrukturës për nevojat e FSK-së dhe MM-së" , me nr. të prok: 217-20-4418-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria e Mbrojtjes".

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit

131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e grupit të operatorëve ekonomik ankues "Arhiko Ing O.P; & Al-Group" SH.P.K-Prishtinë dhe operatorit ekonomik ankues "Taulant" SH.P.K. & "Studio Hapsira" SH.P.K-Prishtinë, aprovohen pjesërisht të bazuara, i'u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Grupi i operatorëve ekonomik ankues "Arhiko Ing O.P; & Al-Group" SH.P.K-Prishtinë, dhe grupi i OE "Taulant" SH.P.K. & "Studio Hapsira" SH.P.K-Prishtinë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 13.11.2020 me nr. 938/20 dhe me 16.11.2020 me nr. 945/20, kundër B58-njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime të projektimit dhe dizajnimit të projekteve të infrastrukturës për nevojat e FSK-së dhe MM-së", me nr. të prok: 217-20-4418-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria e Mbrojtjes", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 59, 60, 65, 66 dhe 69 të LPP-së, te ankesa me nr. 938/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 56, 59, 69 dhe 72 parag.1 dhe 2 të LPP-së ,si dhe 39.8 të RRUOPP-së te ankesa me nr. 945/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.11.2020, ka autorizuar ekspertin-teknik shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues-teknik i prokurimit në raportin e dt: 01.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Arhiko Ing O.P; & Al-Group"SH.P.K-Prishtinë,

Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë – se në FTD "Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1&7.2" kërkesa 7 është kërkuar ISO 14001:2015. Ku kompania e shpallur fituese ka ofruar një Iso të cilës i ka skaduar afati me datën 30.01.2019. OE nuk ka vazhduar procedurën e ri-auditimit të cilat janë vjetore.

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor nr. 1 të parashtruar nga grupi i OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë ankues, duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim si dhe shkresat e dorëzuar nga Operatori ekonomik me rastin e dorëzimit te ofertës konstatoj se tenderuesi ka dorëzuar certifikatat e ISO 14001:2015 - Certifikimi i sistemit për menaxhimin mjedisor e cila është e vlefshme përderisa kompania e lartcekur i përmbushë kërkesat e standardit ISO 14001:2015 dhe përmbush te gjitha përgjegjësit ndaj King Cert: Me poshtë po japim datat ne baze te cilave kjo certifikatë është vlefshme: Data e publikimit të certifikatës :31.01.2019; Data e lëshimit të fundit të certifikatës :31.01.2018; Data e mbarimit të certifikatës; 30.01.2019 e cila datë i nënshtrohet mbikëqyrjeve periodike vjetore dhe për të cilën grupi i OE ka pretendime se kjo certifikatë e ISO me numër: ë-180172 nuk e plotëson kriterin e kërkuar. sepse nuk e ka bërë mbikëqyrjen vjetore e cila datë duhet të jetë: 31.01.2020 Data përfundimtare e certifikatës : 30.01.2021 Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë – se në FTD "Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1&7.2" kërkesa 7 është kërkuar ISO 18001:2015. Ku kompania e shpallur fituese ka ofruar një Iso të cilës i ka skaduar afati me datën 30.01.2019. OE nuk ka vazhduar procedurën e ri-auditimit të cilat janë vjetore.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga grupi i OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë ankues, duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim si dhe shkresat e dorëzuar nga Operatori ekonomik me rastin e dorëzimit te ofertës konstatoj se tenderuesi ka dorëzuar certifikatat e ISO 18001:2015 - Certifikimi i sistemit për menaxhimin mjedisor e cila është e vlefshme përderisa kompania e lartcekur i përmbushë kërkesat e standardit ISO 14001:2015 dhe përmbush te gjitha përgjegjësit ndaj KingCert: Me poshtë po japim datat ne baze te cilave kjo certifikatë është vlefshme:

Data e publikimit të certifikatës :31.01.2019; Data e lëshimit të fundit të certifikatës :31.01.2018;

Data e mbarimit të certifikatës; 30.01.2019 e cila datë i nënshtrohet mbikëqyrjeve periodike vjetore dhe për të cilën grupi i OE ka pretendime se kjo certifikatë e ISO me numër: ë-180171 nuk e plotëson kriterin e kërkuar. sepse nuk e ka bërë mbikëqyrjen vjetore e cila datë duhet të jetë: 31.01.2020 Data përfundimtare e certifikatës : 30.01.2021. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar. Sepse kjo certifikatë e ISO me numër: ë-180171 nuk e plotëson kriterin e kërkuar. sepse nuk e ka bërë mbikëqyrjen vjetore e cila datë duhet të jetë: 31.01.2020

Pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë se gjate qasjes ne dokumente zyrtare nuk janë ofruar vërtetimi tatimor dhe Vërtetimi nga Gjykata Themelore – para publikimit te dhënies se kontratës. Mos ofrimi i këtyre dokumenteve bënë të dyshosh për manipulime.

Përgjigje në Pretendimin nr. 3

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga grupi i OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë ankues, duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: Është kërkuar: Kërkesa 2 OE duhet te ofroj dëshmi nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit. Kërkesa 3. OE duhet te ofroj një formular ekstrakt nga "regjistri gjyqësor" ..... Kurse ne baze te këtyre kërkesave është kërkuar Dëshmia e kërkuar dokumentare: Evidenca 2 dhe 3 Vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore dhe Vërtetimin nga Gjykata themelore - duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës- Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar, sepse vërtetimet për të cilat ka pretendime grupi i operatorëve ekonomik janë kërkuar vetëm per tenderuesin fitues, para publikimit të dhënies së kontratës.

Pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se Menaxheri i projektit Behar Nela nuk përmbush Kërkesat sipas FTD-se ku ne CV dhe Referenca nuk gjenden projekte të kryera në lëmin e kanalizimit dhe ujësjellësit, Ndriçimit të jashtëm si dhe Poligone,

Përgjigje në Pretendimin nr. 4

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga grupi i OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë ankues, duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, te kërkesa 9 - OE duhet të caktoj një menaxher të projektit nga stafi profesional inxh.Dipl. i

Arkitekturës (min.8 vjet nga diplomimi), përvojë pune në tetë (8) vitet e fundit në detyrën e menaxherit të projektimit - duhet të jetë inxhinier i diplomuar sistemi 5 vjeçare ose Master i drejtimeve përkatëse. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 9 Vendimi mbi caktimin e menaxherit te kontratës – kërkohet origjinali i vulosur dhe i nënshkruar nga OE.

Të dëshmohet marrëdhënia e punës me kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër të projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar ,,,,,, OE në ofertën e tij për menaxher të projektit ka caktuar z. Bujar Nela Ing. dipl. I arkitekturës i diplomuar në vitin 1985 mirëpo nuk ka ofruar këtë dëshmi dokumentare: Kontratën e punës të dorëzuar me ofertë nuk e ka të noterizuar nga noteri por vetëm të vulosur nga punëdhënësi, ndërsa është kërkuar që kontrata e punës për Menaxher te projektit të jetë e nënshkruar dhe noterizuar. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar,

Pretendimi nr. 5

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues per inxhinier te Arkitekturës V. Elshani nuk ka ofruar, CV sipas kërkesës se FTD-se si dhe ne Referenca nuk gjenden projekte te kryera ne lëmine e Renovimeve, ndriçimi i jashtëm, Poligone.

Përgjigje në pretendimin nr. 5

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga grupi i OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë ankues, duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, te kërkesa 10 Inxh. dipl. i Arkitekturës, inxhinier eksperienca profesionale min. 5 vjet nga diplomimi, përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën e arkitektit - projektuesit Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 10 Kopja e kontratës se punës të vlefshme ose para kontrata me emër të projektit. Diploma kopje e noterizuar nga vet inxhinieri, Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone, (referencat mund te jenë nga punëdhënësit e mëparshëm apo aktual ne 5 vitet e fundit. CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mial, nr telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës, projektet e realizuar ne fushën e projektimit Eksperti shqyrtues konstaton se OE i shpallur fitues në ofertën e tij për inxhinier projektues ka caktuar z. Valon Elshani Ing. dipl. i arkitekturës i diplomuar në vitin 2012, mirëpo nuk ka ofruar këtë dëshmi dokumentare të kërkuar: Kontrata e punesë nuk është para kontratë e rregullt por është për punë specifike vetëm për 120 ditë pune në vit, mendoj se nuk e plotëson kriterin e kërkuar pasi 120 ditë pune gjatë vitit janë shume pakë për përfundim të projektit. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura

rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 6

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues për inxhinierin L. Ajeti, nuk ka ofruar CV për projekte te ngjashme si dhe Referenca për projekte te kryera ne lëmine e Ndriçimit te jashtëm si dhe poligone.

Përgjigje në Pretendimin nr. 6

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga grupi i OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë ankues, duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, te kërkesa 11 .Inxh. Dipl. i Arkitekturës, inxhinier eksperienca profesionale min. 5 vjet nga diplomimi, përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën e arkitektit - projektuesit Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 11 Kopja e kontratës se punës të vlefshme ose para kontrata me emër të projektit. Diploma kopje e noterizuar nga vet inxhinieri, Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone, (referencat mund te jenë nga punëdhënësit e mëparshëm apo aktual ne 5 vitet e fundit. CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mial, nr telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës, projektet e realizuar ne fushën e projektimit. Eksperti shqyrtues konstaton se OE i shpallur fitues ne ofertën e tij për inxhinier projektues ka caktuar znj. Lindita Ajeti Ing. dipl. i arkitekturës i diplomuar ne vitin 1992, mirëpo nuk ka ofruar këto dëshmi dokumentare të kërkuar: Kontrata e punesë nuk është para kontratë e rregullte por është për pune specifike vetëm për 120 dite pune ne vite, mendoj se nuk e plotëson kriterin e kërkuar pasi 120 dite pune gjatë vitit janë shume pake për përfundim te projektit. Te gjitha referencat për punët e kryera i ka me te vjetra se 5 vite nga data e njoftimit për kontrate CV - personale nuk e ka te plotësuar si duhet , nuk i ka te dhëna e përvojës se punesë si dhe projektet e realizuara Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 7

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues për inxhinierin z. Beqir Ramadani nuk ka ofruar CV dhe Referenca për ne projekte te kryera ne lëmine e Ndriçimit te jashtëm si dhe poligone sipas kërkesës se FTD-se.

Përgjigje në Pretendimin nr. 7

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga grupi i OE "ARHIKO. ING"

O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë ankues, duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, te kërkesa 12 Inxh. Dipl. i Ndërtimtarisë konstruktiv eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit -inxh konstruktiv... Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmi 12 Kopja e kontratës se punës të vlefshme ose para kontrata me emër të projektit. Diploma kopje e noterizuar nga vet inxhinieri, Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone, (referencat mund te jenë nga punëdhënësit e mëparshëm apo aktual ne 5 vitet e fundit. CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mial, nr. telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës, projektet e realizuar ne fushën e projektimit
Eksperti shqyrtues konstaton se OE i shpallur fitues ne ofertën e tij për inxhinier ndërtimtarisë ka caktuar z, Beqir Ramadani i cili me dëshmitë e ofruara i plotëson të gjitha kërkesat e kërkuar në njoftimin për kontratë , Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi nr. 8

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues për inxhinierin e ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv z. Agron Blakaj inxhinier të kësaj lëmie . Ku CV dhe Referenca CV-ja e sipas FTD-se sipas kërkesës 13. në projekte të kryera në lëmin e ndriçimit të jashtëm si dhe poligone sipas kërkesës së FTD-së

Përgjigje në Pretendimin nr. 8

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga grupi i OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë ankues, duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, te kërkesa 13 Inxh. Dipl. i Ndërtimtarisë - konstruktiv - eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit -inxh konstruktiv... Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmi 13 Kopja e kontratës se punës të vlefshme ose para kontrata me emër të projektit. Diploma kopje e noterizuar nga vet inxhinieri, Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone, (referencat mund te jenë nga punëdhënësit e mëparshëm apo aktual ne 5 vitet e fundit. CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mial, nr. telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës, projektet e realizuar ne fushën e projektimit

Eksperti shqyrtues konstaton se OE i shpallur fitues ne ofertën e tij për inxhinier ndërtimtarisë ka caktuar z, Agron Blakaj Ing. dipl. i ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv i diplomuar ne vitin 2009, mirëpo nuk ka ofruar këto dëshmi dokumentare të kërkuar: Kontrata e punesë nuk është para kontratë e rregullte por është për pune specifike vetëm për 120 dite pune ne vite, mendoj se nuk e plotëson kriterin e kërkuar pasi 120 dite pune gjatë vitit janë shume pake për përfundim te projektit. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 9

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues për inxhinierin e Hamdi Bytyçi nuk ka ofruar CV si dhe Referenca ne projekte te kryera ne lëmin e Ndriçimit te jashtëm, ujësjellës dhe kanalizim, si dhe poligone sipas kërkesë se FTD-se

Përgjigje në Pretendimin nr. 9

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga grupi i OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë ankues, duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, te kërkesa 15 Inxh. inxhinierin e Makinerisë - eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit - inxhinierin e Makinerisë... Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmi 15 Kopja e kontratës se punës të vlefshme ose para kontrata me emër të projektit. Diploma kopje e noterizuar nga vet inxhinieri, Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone, (referencat mund te jenë nga punëdhënësit e mëparshëm apo aktual ne 5 vitet e fundit. CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mial, nr. telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës, projektet e realizuar ne fushën e projektimit Eksperti shqyrtues konstaton se OE i shpallur fitues ne ofertën e tij për inxhinier ndërtimtarisë ka caktuar z, Hamdi Bytyçi inxhinierin e Makinerisë i diplomuar ne vitin 1991, mirëpo nuk ka ofruar këto dëshmi dokumentare të kërkuar:

Kontrata e punesë nuk është para kontratë e rregullte por është për pune specifike vetëm për 120 dite pune ne vite, mendoj se nuk e plotëson kriterin e kërkuar pasi 120 dite pune gjatë vitit janë shume pake për përfundim te projektit. CV - personale nuk e ka te plotësuar si duhet , nuk i ka te dhëna: email adresën si dhe projektet e realizuara. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar,

Pretendimi nr. 10

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues për inxhinierin e elektroteknikes Florim Sylejmani ne CV nuk janë ofruar projekte ne fushën e Poligoneve si dhe Referenca për këtë lëmi. Ku nga kjo shihet qe CV –ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat e AK

Përgjigje në Pretendimin nr . 10

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga grupi i OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë ankues, duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, te kërkesa 16 Inxh. inxhinierin e elektroteknikes - eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit - inxhinierin e elektroteknikes ... Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmi 16 Kopja e kontratës se punës të vlefshme ose para kontrata me emër të projektit. Diploma kopje e noterizuar nga vet inxhinieri, Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone, (referencat mund te jenë nga punëdhënësit e mëparshëm apo aktual ne 5 vitet e fundit. CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mial, nr. telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës, projektet e realizuar ne fushën e projektimit Eksperti shqyrtues konstaton se OE i shpallur fitues ne ofertën e tij për inxhinier ndërtimtarisë ka caktuar z, Florim Sylejmani inxhinierin e elektroteknikes i diplomuar ne vitin 2006, mirëpo nuk ka ofruar këto dëshmi dokumentare të kërkuar: Kontrata e punesë nuk është para kontratë e rregullte por është për pune specifike vetëm për 120 dite pune ne vite, mendoj se nuk e plotëson kriterin e kërkuar pasi 120 dite pune gjatë vitit janë shume pake për përfundim te projektit. Ne referencat e dorëzuara nuk e ka te specifikuar se ka punuar ndriçim për poligone. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar,

Pretendimi nr .11

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues për inxhinierin e elektroteknikes (kompjuterike)ka caktuar z. Valon Kastrati ku CV-ja e inxhinierit nuk përmbush asnjë kërkesë sipas FTD-se sipas kërkesës 17.

Përgjigje në Pretendimin nr. 11

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga grupi i OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë ankues, duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe

profesional, te kërkesa 17, Inxh. Dipl. i Elektroteknikës, drejtimi kompjuterikë me telekomunikacion - eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit . Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmi 17 Kopja e kontratës se punës të vlefshme ose para kontrata me emër të projektit. Diploma kopje e noterizuar nga vet inxhinieri, Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone, (referencat mund te jenë nga punëdhënësit e mëparshëm apo aktual ne 5 vitet e fundit. CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mial, nr. telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës, projektet e realizuar ne fushën e projektimit

Eksperti shqyrtues konstaton se OE i shpallur fitues ne ofertën e tij për inxhinier Elektroteknikës, drejtimi kompjuterikë me telekomunikacion ka caktuar z, Valon Kastrati inxhinierin e elektroteknikes drejtimi kompjuterikë me telekomunikacion i diplomuar ne vitin 2005, mirëpo nuk ka ofruar këto dëshmi dokumentare të kërkuar: Kontrata e punesë nuk është para kontratë e rregullte por është për pune specifike vetëm për 120 dite pune ne vite, mendoj se nuk e plotëson kriterin e kërkuar pasi 120 dite pune gjatë vitit janë shume pake për përfundim te projektit.

Nuk ka dorëzuar referenca për punët e kryera CV - personale nuk e ka te plotësuar si duhet, nuk i ka të dhëna: numrin e telefonit si dhe email adresën. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar,

Pretendimi nr. 12

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues për Inxhinier te Gjeodezisë ka caktuar z. Ilir Gashi i cili nuk i plotëson kriteret e kërkuara sepse: Nuk ka kryer projekte të lëmisë së renovime, kanalizimi dhe ujësjellësi, ndriçim i jashtëm, poligone të cilat nuk gjenden në CV dhe Referenca, nuk përmbush kërkesat sipas FTD-së, sipas kërkesës 18.

Përgjigje në Pretendimin nr. 12

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga grupi i OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë ankues, duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin per Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, të kërkesa 18. Inxh. Dipl. i Gjeodezisë eksperienca profesionale min.5 vite, Dëshmi 18 - Kopja e kontratës se punës të vlefshme ose para kontrata me emër të projektit. Diploma kopje e noterizuar nga vet inxhinieri, Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone, (referencat mund te jenë nga punëdhënësit e mëparshëm apo

aktual ne 5 vitet e fundit. CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mial,nr telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës, projektet e realizuar ne fushën e projektimit Licencë valide për shërbime gjeodezike sipas ligjit te aplikueshëm ne RKS. Eksperti shqyrtues konstaton se OE i shpallur fitues ne ofertën e tij për Inxh. dipl. i Gjeodezisë ka caktuar z. Ilir Gashi - me diplomë MASTER PROFESIONAL në Inxhinieri GJEODEZI i diplomuar me datën 19. 07. 2017 -andaj nuk e plotëson kriterin e kërkuar sipas III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, të kërkesa 18. Inxh. Dipl. i Gjeodezisë eksperienca profesionale min.5 vite si dhe është kërkuar qe te jete Diploma kopje e noterizuar nga vet inxhinieri kurse për vërtetim e ka prezantuar Kadri Gashi Njëherit OE i shpallur fitues për Inxh. dipl. i Gjeodezisë ka caktuar dhe z. Lorenc Zani - me diplomë Inxhinier GJEODET i diplomuar me datën 3 tetor . 1996 ne Universitetin Politeknik te Tiranës i cili nuk e plotëson kriterin qe te posedoj Licencë valide për shërbime gjeodezike sipas ligjit te aplikueshëm ne RKS. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 13

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues për inxhinierin e ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknik Burim Dula inxhinier te kësaj lëmie. Ku CV dhe Referenca CV-ja e sipas FTD-se sipas kërkesës 14. ne projekte te kryera ne lëmin e Ndriçimit te jashtëm si dhe poligone sipas kërkesën se FTD-se

Përgjigje në Pretendimin .13

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga grupi i OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë ankues, duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, te kërkesa 14 Inxh. Dipl. i Ndërtimtarisë Hidroteknik - eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit -inxh Hidroteknik ... Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmi 14 Kopja e kontratës se punës të vlefshme ose para kontrata me emër të projektit. Diploma kopje e noterizuar nga vet inxhinieri, Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone, (referencat mund te jenë nga punëdhënësit e mëparshëm apo aktual ne 5 vitet e fundit. CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mial, nr. telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës, projektet e realizuar ne fushën e projektimit Eksperti shqyrtues konstaton se OE i shpallur fitues ne ofertën e tij për inxhinier ndërtimtarisë – Hidroteknik ka caktuar z, Burim Dula i cili me dëshmitë e ofruara i plotëson të gjitha kërkesat e kërkuar

në njoftimin për kontratë , Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar,

Pretendimi nr. 14

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE I shpallur fitues nuk e plotëson Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kërkesa 19 Është kërkuar Skema e organizative e personelit te kompanisë. OE ne fjale ka ofruar një Organogram ne te cilin nuk janë përfshirë Gjeodetet ne fjale.

Përgjigje në Pretendimin nr .14

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga grupi i OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë ankues, duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional kërkesa 19. Kërkesa 19 Skema e organizative e personelit te kompanisë Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmi 19- Organogrami i kompanisë – origjinali i nënshkruar dhe vulosur Eksperti shqyrtues dhatë shqyrtimit te dokumentacionit përkatësisht te organogramit te dorëzuar të kompanisë te grupi i projektueseve për gjeodezi nga OE është shënuar emri i Luan Abazi - MSC i Gjeodezisë të cilin nuk e ka të përfshirë në regjistrin e stafit profesional dhe për të cilin nuk i ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar me dëshmi ne baze kërkesave te përcaktuara me njoftimin për kontrate. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Taulant" SH.P.K; & "Studio Hapsira"SH.P.K-Prishtinë

Më datën 28.10.2020 ,jemi njoftuar nga Autoriteti Kontraktues lidhur me eliminimin tonë lidhur me pretendimet e specifikuar sipas vendimi Poshtë :

Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin e grupit të OE ANKUES "TAULANT" SH.P.K. & "STUDIO HAPSIRA" SH.P.K" Prishtinë – për arsyet e eliminimit bazuar në mos pajtueshmërisë prej Pikës 1 deri 9 sipas pretendimeve Ankimore. Mungojnë Kontrata e vlefshme lidhur me këtë projekt, CV-ja personale Origjinale; Referenca Pozitive nga Punëmarrësi, Sqarim : Ju informojmë që në Dosjen e tenderit keni përcaktuar kërkesa dhe kritere mjaftë voluminoze që për plotësimin e dokumentacioni na janë krijuar një numër i madh i dokumenteve për shkak të sasi së kufizuar të Megabajteve dhe fletë ngarkuese në E-prokurimi ka qenë i pamundur ti ngarkojmë të gjitha dokumentet në e-prokurim , vetë sistemi nuk na marr një numër të dokumenteve të cilat kemi dashur ti ngarkojmë. Ne kemi prezantuar listën e stafit të angazhuar në këtë projekt , e inxhinierëve duke i bashkangjitur edhe diplomat për secilin Kërkesat mbi

mundësitë teknike dhe/ose profesionale kërkesë të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI 9.1. Disa prej dokumenteve të cilat nuk kemi mundur ti ngarkojmë në e-prokurim , Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit ofertave është dashur të kërkojnë informata sqaruese konform NENI 39.8 (RRUOP) dhe në pajtim me NENI 66 të LPP-së. Me këtë rast Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundërshtim NENI 39.8 (RRUOP) dhe NENI 66 të LPP-së , pa kërkuar informatat plotësues na ka refuzuar tenderi tonë .

Përgjigje në Pretendimin nr. 1

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga grupi i OE "TAULANT" SH.P.K. & "STUDIO HAPSIRA" SH.P.K" PRISHTINE ankues, shqyrtimit te dokumentacionit qe kam pasur ne dispozicion përkatësisht te Dosjes se Tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), Dokumentet qe përbejnë Tenderin pika 19.1 (h) ne te cilën thuhet: Ju lutem qe gjatë përgatitjes dhe ngarkimit të ofertës tuaj në sistemin e e-prokurimit të keni parasysh dhe të ngarkoni, se bashku me ofertën tuaj, vetëm dokumentet të cilat kërkohen në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Me qëllim qe të mos ngarkohet sistemit pa nevoje me dokumente të cilat NUK KËRKOHEN nga AK/MM në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, janë të panevojshëm dhe pavlefshme derisa sa nuk kërkohen. Eksperti shqyrtues gjatë shqyrtimit të dokumentacionit që ka pasur ne dispozicion konstaton se Grupi i Operatorëve Ekonomik ankues "TAULANT SHPK&STUDIO HAPSIRA SHPK " në sistemin e-prokurimit ka ngarkuar një mori të dokumenteve të cilat nuk janë kërkuar dhe të pa nevojshme, ndërsa dokumentet kyçe të kërkuara nuk i ka ngarkuara, dhe njëherit gjatë shqyrtimit të gjithë dokumentacionit të ofruar të gjithë Operatoreve Ekonomik pjesëmarrës të cilët kanë dorëzuar ofertat për ketë aktivitet të prokurimit nuk kanë paraqitur ndonjë shqetësim apo problem në ngarkim të dokumenteve që janë kërkuar, si pasoj e hapësirës së kufizuar në e-prokurim, andaj sqarimi se ngarkimi i dokumenteve në e-prokurim ka qen i pa mundur për shkak të hapësirës së kufizuar është i pa qëndrueshëm,

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se AK nuk ka kërkuar informacione sqaruese konform nenit 72 i LPP-së - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, paragrafi 3. Ne te cilin thuhet se:-Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Bazuar në nenin 72 te LPP-se Autoriteti Kontraktues – komisioni vlerësues, gjatë Vlerësimit të tenderëve nuk ka hasur në dëshmi qe e vërteton ekzistencën dokumentacion per të cilat në bazë të këtij neni mund të kërkohen informata sqaruese,

Eksperti shqyrtues konstaton se operatori ekonomik nuk i plotësinë kërkesat e kërkuar me III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: dhe atë për: Kërkesa 9. OE duhet të caktoj një menaxher të projektit nga stafi profesional inxh. dipl. i Arkitekturës (min.8 vjet nga diplomimi),

Nuk ka dorëzuar dëmshmit e kërkuara dokumentare : Vendimi mbi caktimin e menaxherit te kontratës –

kërkohet origjinali i vulosur dhe i nënshkruar nga OE. kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone Kërkesa 10. Inxh. dipl. i Arkitekturës inxhinier eksperienca profesionale min. 5 vjet nga diplomimi Nuk ka dorëzuar dëmshmit e kërkuara dokumentare : Kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar. Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone. Kërkesa 11. Inxh. dipl. i Arkitekturës inxhinier eksperienca profesionale min. 5 vjet nga diplomimi, Nuk ka dorëzuar dëmshmit e kërkuara dokumentare : Kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar.

Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone. Kërkesa 12. Inxh. dipl. i Ndërtimtarisë konstruktiv - eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit Nuk ka dorëzuar dëmshmit e kërkuara dokumentare : Kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar. Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone Kërkesa 13.Inxh. dipl. i Ndërtimtarisë konstruktiv - eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit

Nuk ka dorëzuar dëmshmit e kërkuara dokumentare : Kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone. Kërkesa 14. Inxh. dipl. i. Ndërtimtarisë hidroteknik , eksperienca profesionale min.5 vite nga diplomimi, përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit Nuk ka dorëzuar dëmshmit e kërkuara dokumentare :

Kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, analizës konkrete dhe deklarimit të palëve në procedurë, në vijim jep përgjigjet në pretendimet ankimore.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: "Arhiko Ing O.P; & Al-Group"SH.P.K-Prishtinë

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë – se në FTD "Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1&7.2" kërkesa 7 është kërkuar ISO 14001:2015. Ku kompania e shpallur fituese ka ofruar një Iso të cilës i ka skaduar afati me datën 30.01.2019. OE nuk ka vazhduar procedurën e ri-auditimit të cilat janë vjetore.

Paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim i ankuesit nuk ka qene pretendim i paraqitur ne fazën e kërkesës per rishqyrtim pran AK. Paneli shqyrtues me rastin e marrjes së këtij vendimi, është bazuar në pretendimet ankimore të parashtruara tek kërkesa për rishqyrtim dhe tek ankesa e dorëzuar në OSHP, sepse në nenin 9.2 tek Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave, shkruan decidivisht se pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato te paraqitura në Autoritetin Kontraktues, ndërsa çdo pretendim tjetër që është ngritur në seancë dëgjimore dhe që nuk ka kaluar nëpër filtrat e rishqyrtimit tek autoriteti kontraktues nuk është marr parasysh dhe nuk është i përfshirë në këtë vendim .

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë – se në FTD "Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1&7.2" kërkesa 7 është kërkuar ISO 18001:2015. Ku kompania e shpallur fituese ka ofruar një Iso të cilës i ka skaduar afati me datën 30.01.2019. OE nuk ka vazhduar procedurën e ri-auditimit të cilat janë vjetore.

Paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim i ankuesit nuk ka qene pretendim i paraqitur ne fazën e kërkesës per rishqyrtim pran AK. Paneli shqyrtues me rastin e marrjes së këtij vendimi, është bazuar në pretendimet ankimore të parashtruara tek kërkesa për rishqyrtim dhe tek ankesa e dorëzuar në OSHP, sepse në nenin 9.2 tek Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave, shkruan decidivisht se pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato te paraqitura në Autoritetin Kontraktues, ndërsa çdo pretendim tjetër që është ngritur në seancë dëgjimore dhe që nuk ka kaluar nëpër filtrat e rishqyrtimit tek autoriteti kontraktues nuk është marr parasysh dhe nuk është i përfshirë në këtë vendim .

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Prishtinë se gjate qasjes ne dokumente zyrtare nuk janë ofruar vërtetimi tatimor dhe Vërtetimi nga Gjykata Themelore – para publikimit te dhënies se kontratës dhe se mos ofrimi i këtyre dokumenteve bënë të dyshosh për manipulime,

Paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim i ankuesit nuk ka qene pretendim i paraqitur ne fazën e kërkesës per rishqyrtim pran AK. Paneli shqyrtues me rastin e marrjes së këtij vendimi, është bazuar në pretendimet ankimore të parashtruara tek kërkesa për rishqyrtim dhe tek ankesa e dorëzuar në OSHP, sepse në nenin 9.2 tek Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave, shkruan decidivisht se pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato te paraqitura në Autoritetin Kontraktues, ndërsa çdo pretendim tjetër që është ngritur në seancë dëgjimore dhe që nuk ka kaluar nëpër filtrat e rishqyrtimit tek autoriteti kontraktues nuk është marr parasysh dhe nuk është i përfshirë në këtë vendim .

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se Menaxheri i projektit Behar Nela nuk përmbush Kërkesat sipas FTD-se ku ne CV dhe Referenca nuk gjenden projekte të kryera në lëmin e kanalizimit dhe ujësjellësit, Ndriçimit të jashtëm si dhe Poligone, paneli shqyrtues sqaron duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika: III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, te kërkesa 9 - OE duhet të caktoj një menaxher të projektit nga stafi profesional inxh.Dipl. i Arkitekturës (min.8 vjet nga diplomimi), përvojë pune në tetë (8) vitet e fundit në detyrën e menaxherit të projektimit - duhet të jetë inxhinier i diplomuar sistemi 5 vjeçare ose Master i drejtimeve përkatëse. Dëshmia e kërkuar

dokumentare: Dëshmia 9 Vendimi mbi caktimin e menaxherit te kontratës – kërkohet origjinali i vulosur dhe i nënshkruar nga OE. Të dëshmohet marrëdhënia e punës me kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër të projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit te te gjitha provave te dërguara nga palët dhe dokumentacionit ne materialin ofertues konstaton se tenderuesi me dëshmitë e ofruara i plotëson të gjitha kërkesat e kërkuar në njoftimin për kontratë, po ashtu edhe kontratën valide (ATK) për menagjerin e kontratës, në dosjen e tenderit gjendet edhe lista e ATK-se e qe vërteton se z Bujar Nela është ne marrëdhënie pune te ENG IDEA shpk. Kjo plotëson pjesën e parë të kërkesës se FDT-se sepse noterizimi është kërkuar per parakontrat per OE qe menaxherin e kontratës nuk e kane punëtorë te rregullt. Paneli shqyrtues e cilëson kete pretendim si të pa-bazuar.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues per inxhinier te Arkitekturës V. Elshani nuk ka ofruar, CV sipas kërkesës se FTD-se si dhe ne Referenca nuk gjenden projekte te kryera ne lëmine e Renovimeve, ndriçimi i jashtëm, Poligone, paneli shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, te kërkesa 10 Inxh. dipl. i Arkitekturës, inxhinier eksperienca profesionale min. 5 vjet nga diplomimi, përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën e arkitektit - projektuesit Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 10 Kopja e kontratës se punës të vlefshme ose para kontrata me emër të projektit. Diploma kopje e noterizuar nga vet inxhinieri, Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë, objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone, (referencat mund te jenë nga punëdhënësit e mëparshëm apo aktual ne 5 vitet e fundit. CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mial, nr telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës, projektet e realizuar ne fushën e projektimit . Paneli shqyrtues vlerëson se bazuar ne Rregulloren Nr. 01/2020 Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, e cila ne nenin 13, pika 9 thekson "Ankesa duhet të jetë e qartë, e shkurtër dhe me pretendimet e supozuara, që eventualisht janë shkelur nenet e caktuara të LPP-së, nga ana e autoritetit kontraktues. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues." Paneli shqyrtues ka vërejtur se ka ndryshime te pretendimeve pran AK dhe ankesës se paraqitur ne OSHP nga ankuesi. Paneli shqyrtues pas analizës se provave te dokumentacionit te ofruar nga tenderuesi vlerëson se Z. Valon Elshani plotëson kriteret e kërkuara me Dosje te Tenderit dhe Njoftimt për Kontrate, për pozitën Inxh. i Arkitekturës, sa i përket kontratës për punë specifike ajo është në përputhje me Ligjin e Punës - Ligji Nr. 03/L-212, andaj pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues për inxhinierin L. Ajeti, nuk ka ofruar CV për projekte te ngjashme si dhe Referenca për projekte te kryera ne lëmine e Ndriçimit te jashtëm si dhe poligone,

Paneli shqyrtues vlereson se bazuar ne Rregulloren Nr. 01/2020 Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, e cila ne nenin 13, pika 9 thekson "Ankesa duhet të jetë e qartë, e shkurtër dhe me pretendimet e supozuara, që eventualisht janë shkelur nenet e caktuara të LPP-së, nga ana e autoritetit kontraktues. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues." Paneli shqyrtues ka vërejtur se ka ndryshime te pretendimeve pran AK dhe ankesës se paraqitur ne OSHP nga ankuesi.

Paneli shqyrtues pas analizës se provave te dokumentacionit te ofruar nga tenderuesi vlerëson se Znj. Lindita Ajeti Ing. dipl. i arkitekturës i diplomuar ne vitin 1992 plotëson kriteret e kërkuara me Dosje te Tenderit dhe Njoftimet për Kontrate, për pozitën Inxh. i Arkitekturës, sa i përket kontratës për punë specifike ajo është në përputhje me Ligjin e Punës - Ligji Nr. 03/L-212, kurse referencat individuale nuk mund te kufizohen ne pese vitet e fundit, andaj pretendimi i OE ankues është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues për inxhinierin z. Beqir Ramadani nuk ka ofruar CV dhe Referenca për ne projekte te kryera ne lëmine e Ndriçimit te jashtëm si dhe poligone sipas kërkesës se FTD-se, paneli shqyrtues duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, te kërkesa 12 Inxh. Dipl. i Ndërtimtarisë konstruktiv eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit - inxh konstruktiv... Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmi 12 Kopja e kontratës se punës të vlefshme ose para kontrata me emër të projektit. Diploma kopje e noterizuar nga vet inxhinieri, Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë, objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone, (referencat mund te jenë nga punëdhënësit e mëparshëm apo aktual ne 5 vitet e fundit. CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mial, nr. telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës, projektet e realizuar ne fushën e projektimit

Nga shkresat e ofertës shihet se OE i shpallur fitues ne ofertën e tij për inxhinier ndërtimtarisë ka caktuar z, Beqir Ramadani i cili me dëshmitë e ofruara i plotëson të gjitha kërkesat e kërkuar në njoftimin për kontratë, prandaj pretendimi ankimor është i pa-bazuar.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur

fitues për inxhinierin e ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv z. Agron Blakaj inxhinier të kësaj lëmie ku CV dhe Referenca CV-ja e sipas FTD-se sipas kërkesës 13. në projekte të kryera në lëmin e ndriçimit të jashtëm si dhe poligone sipas kërkesës së FTD-së, Paneli shqyrtues vlerëson se bazuar ne Rregulloren Nr. 01/2020 Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, e cila ne nenin 13, pika 9 thekson "Ankesa duhet të jetë e qartë, e shkurtër dhe me pretendimet e supozuara, që eventualisht janë shkelur nenet e caktuara të LPP-së, nga ana e autoritetit kontraktues. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues." Paneli shqyrtues ka vërejtur se ka ndryshime te pretendimeve pran AK dhe ankesës se paraqitur ne OSHP nga ankuesi.
Paneli shqyrtues pas analizës se provave te dokumentacionit te ofruar nga tenderuesi vlerëson se Z. Agron Blakaj plotëson kriteret e kërkuara me Dosje te Tenderit dhe Njoftimit për Kontrate, për pozitën Inxh. i Ndërtimtarisë, sa i përket kontratës për punë specifike ajo është në përputhje me Ligjin e Punës - Ligji Nr. 03/L-212, andaj pretendimi i OE ankues është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues për inxhinierin e Hamdi Bytyçi nuk ka ofruar CV si dhe Referenca ne projekte te kryera ne lëmin e Ndriçimit te jashtëm, ujësjellës dhe kanalizim, si dhe poligone sipas kërkesë se FTD-se, paneli shqyrtues duke u bazuar në kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, te kërkesa 15 Inxh. inxhinierin e Makinerisë - eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit - inxhinierin e Makinerisë... Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmi 15 Kopja e kontratës se punës të vlefshme ose para kontrata me emër të projektit. Diploma kopje e noterizuar nga vet inxhinieri, Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone, (referencat mund te jenë nga punëdhënësit e mëparshëm apo aktual ne 5 vitet e fundit. CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mial, nr. telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës, projektet e realizuar ne fushën e projektimit. Paneli shqyrtues konstaton se OE i shpallur fitues ne ofertën e tij për inxhinier makinerisë ka caktuar z, Hamdi Bytyçi inxhinierin e Makinerisë i diplomuar ne vitin 1991, dhe ka ofruar dëshmi dokumentare të kërkuar: Kontrata e punës nuk është para kontratë e rregullte por është për pune specifike vetëm për 120 dite pune ne vite, CV - personale nuk e ka te plotësuar si duhet, nuk i ka te dhënat: email adresën si dhe projektet e realizuara, por paneli shqyrtues vlerëson sa i përket kontratës për punë specifike ajo është në përputhje me Ligjin e Punës - Ligji Nr. 03/L-212. AK ka pas mundësi të kërkoj sqarime shtesë nga OE që për inxhinierin në fjalë të ridërgoj edhe një herë CV në mënyrë që të vërtetohet se i njëjti a është konform kërkesave të

dosjes së tenderit apo jo, mirëpo ne dosjen e tenderit referencat e ofruara nga OE i shpallur fitues dëshmojnë eksperiencën e kërkuar ne FDT. AK nuk ka shfrytëzuar instrumentet ligjore qe i ofron LPP per sqarime, andaj ky pretendim është pjesërisht i qëndrueshëm, por bazuar ne nenin 59 te LPP-ës, devijimi është i vogël dhe nuk dëmton kushtin material te procedurës dhe kontratës.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues për inxhinierin e elektroteknikes Florim Sylejmani ne CV nuk janë ofruar projekte ne fushën e Poligoneve si dhe Referenca për këtë lëmi. Paneli shqyrtues vlerëson se bazuar ne Rregulloren Nr. 01/2020 Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, e cila ne nenin 13, pika 9 thekson "Ankesa duhet të jetë e qartë, e shkurtër dhe me pretendimet e supozuara, që eventualisht janë shkelur nenet e caktuara të LPP-së, nga ana e autoritetit kontraktues. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues." Paneli shqyrtues ka vërejtur se ka ndryshime te pretendimeve pran AK dhe ankesës se paraqitur ne OSHP nga ankuesi.

Paneli shqyrtues pas analizës se provave te dokumentacionit te ofruar nga tenderuesi vlerëson se Z. Florim Sylejmani plotëson kriteret e kërkuara me Dosje te Tenderit dhe Njoftimit për Kontrate, për pozitën Inxh. i Ndërtimtarisë, sa i përket kontratës për punë specifike ajo është në përputhje me Ligjin e Punës - Ligji Nr. 03/L-212. Sa i përket pretendimit se ne reference nuk ka paraqitur ndriçim per poligone, ne baza te LPP asnjë OE nuk mund te eliminohet per kërkesa qe nuk janë paraqitur ne FDT, nuk kërkohet reference per ndriçim ne poligone, e qe kjo është e rregulluar paragrafin 3 te nenit 56, andaj pretendimi i OE ankues është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues për inxhinierin e elektroteknikes (kompjuterike)ka caktuar z. Valon Kastrati ku CV-ja e inxhinierit nuk përmbush asnjë kërkesë sipas FTD-se sipas kërkesës 17. Duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, te kërkesa 17, Inxh. Dipl. i Elektroteknikës, drejtimi kompjuterikë me telekomunikacion - eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit . Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmi 17 Kopja e kontratës se punës të vlefshme ose para kontrata me emër të projektit. Diploma kopje e noterizuar nga vet inxhinieri, Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë, objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone, (referencat mund te jenë nga punëdhënësit e mëparshëm apo aktual ne 5 vitet e fundit. CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personale, kontaktin, e-mial, nr. telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e

punës, projektet e realizuar ne fushën e projektimit OE i shpallur fitues ne ofertën e tij për inxhinier Elektroteknikës, drejtimi kompjuterikë me telekomunikacion ka caktuar z, Valon Kastrati inxhinierin e elektroteknikes drejtimi kompjuterikë me telekomunikacion i diplomuar ne vitin 2005, mirëpo nuk ka ofruar këto dëshmi dokumentare të kërkuar: Kontrata e punesë nuk është para kontratë e rregullte por është për pune specifike vetëm për 120 dite pune ne vite, nuk ka dorëzuar referenca për punët e kryera CV - personale nuk e ka te plotësuar si duhet, nuk i ka të dhëna: numrin e telefonit si dhe email adresën, megjithatë paneli shqyrtues mendon se ky pretendim është pjesërisht i bazuar, sa i përket kontratës për punë specifike ajo është në përputhje me Ligjin e Punës - Ligji Nr. 03/L-212, si dhe se mos plotësimi i CV me informatat e cekura si më lartë përben një devijim të vogël andaj AK mund të kërkoj nga OE ankues që ti ofroj CV ashtu siç kërkohet në dosje të tenderit.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues për Inxhinier te Gjeodezisë ka caktuar z. Ilir Gashi i cili nuk i plotëson kriteret e kërkuara sepse: Nuk ka kryer projekte të lëmisë së renovime, kanalizimi dhe ujësjellësi, ndriçim i jashtëm, poligone të cilat nuk gjenden në CV dhe Referenca, nuk përmbush kërkesat sipas FTD-së, sipas kërkesës 18, Paneli shqyrtues konstaton se OE i shpallur fitues ne ofertën e tij për Inxh. dipl. i Gjeodezisë ka caktuar z. Ilir Gashi - me diplomë MASTER PROFESIONAL në Inxhinieri GJEODEZI i diplomuar me datën 19. 07. 2017 -andaj nuk e plotëson kriterin e kërkuar sipas III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, të kërkesa 18. Inxh. Dipl. i Gjeodezisë eksperienca profesionale min.5 vite si dhe është kërkuar qe te jete Diploma kopje e noterizuar nga vet inxhinieri kurse për vërtetim e ka prezantuar Kadri Gashi Njëherit OE i shpallur fitues për Inxh. dipl. i Gjeodezisë ka caktuar dhe z. Lorenc Zani - me diplomë Inxhinier GJEODET i diplomuar me datën 3 tetor . 1996 ne Universitetin Politeknik te Tiranës i cili nuk e plotëson kriterin qe te posedoj Licencë valide për shërbime gjeodezike sipas ligjit te aplikueshëm ne RKS.
Megjithatë, Paneli Shqyrtues me date 09.12 2020 ka pranuar nga OE i rekomanduar per kontrate nëpërmjet parashtresës me shkrim dokumentacionin e z. Ilir Gashi përfshi kopjen e diplomave te notarizuar nga vete Ilir Gashi (diploma bachelor, Diploma Master dhe Licenca), andaj paneli shqyrtues cilëson këtë pretendim si pjesërisht te bazuar, sepse evidenton se Z. Ilir Gashi është i diplomuar bachelor ne vitin 2012, dhe master ne vitin 2017, i licencuar si Gjeodet konform Ligjeve te Republikës se Kosovës, po ashtu figuron ne listën e punëtorëve te rregullt te lëshuar nga ATK ne emër te OE te shpallur fitues.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE i shpallur fitues për inxhinierin e ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknik Burim Dula inxhinier te kësaj lëmie. Ku CV dhe Referenca CV-ja e sipas FTD-se sipas kërkesës 14. ne projekte te kryera ne lëmin e Ndriçimit te jashtëm si dhe poligone sipas kërkesën se FTD-së paneli shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne kriteret e

kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika : III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, te kërkesa 14 Inxh. Dipl. i Ndërtimtarisë Hidroteknik - eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit -inxh Hidroteknik ... Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmi 14 Kopja e kontratës se punës të vlefshme ose para kontrata me emër të projektit. Diploma kopje e noterizuar nga vet inxhinieri, Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone, (referencat mund te jenë nga punëdhënësit e mëparshëm apo aktual ne 5 vitet e fundit. CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mial, nr. telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës, projektet e realizuar ne fushën e projektimit, paneli shqyrtues konstaton se OE i shpallur fitues ne ofertën e tij për inxhinier ndërtimtarisë –Hidroteknik ka caktuar z, Burim Dula i cili me dëshmitë e ofruara i plotëson të gjitha kërkesat e kërkuar në njoftimin për kontratë, prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "ARHIKO. ING" O.P & "AL-GROUP" SHPK. Se OE I shpallur fitues nuk e plotëson Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kërkesa 19 është kërkuar Skema e organizative e personelit te kompanisë. OE ne fjale ka ofruar një Organogram ne te cilin nuk janë përfshirë Gjeodetet ne fjale, paneli shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne kriteret e kërkuara ne Njoftimin për Kontrate respektivisht tek pika: III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional kërkesa 19. Kërkesa 19 Skema e organizative e personelit te kompanisë Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmi 19- Organogrami i kompanisë – origjinali i nënshkruar dhe të vulosur, paneli shqyrtues pas shqyrtimit te dokumentacionit përkatësisht te organogramit te dorëzuar të kompanisë te grupi i projektueseve për gjeodezi nga OE është shënuar emri i Luan Abazi - MSC i Gjeodezisë të cilin nuk e ka të përfshirë në regjistrin e stafit profesional dhe për të cilin nuk i ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar me dëshmi ne baze kërkesave te përcaktuara me njoftimin për kontrate. , ne baza te paragrafit 3 te nenit 56 te LPP asnjë OE nuk mund te eliminohet per kërkesa qe nuk janë paraqitur ne FDT, andaj pretendimi i OE ankues është i pabazuar, nuk është kërkuar organogram per këtë projekt specifik por per kompaninë, andaj Paneli nuk mund te futet ne paragjykime nëse Luan Abazi është pjese e kësaj kompanie apo jo, si punëtorë, bashkëpunëtor profesional apo ndonjë këshilltarë i jashtëm per çështje gjeodezike.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Taulanti" SH.P.K; & "Studio Hapsira"SH.P.K-Prishtinë

Lidhur me pretendimin e grupit të OE ANKUES "TAULANT" SH.P.K. & "STUDIO HAPSIRA"

SH.P.K" Prishtinë – për arsyet e eliminimit bazuar në mos pajtueshmërisë prej Pikës 1 deri 9 sipas pretendimeve ankimore, mungojnë kontrata e vlefshme lidhur me këtë projekt, CV-ja personale origjinale; referenca pozitive nga punëmarrësi, sqarim : Ju informojmë që në Dosjen e tenderit keni përcaktuar kërkesa dhe kritere mjaftë voluminoze që për plotësimin e dokumentacioni na janë krijuar një numër i madh i dokumenteve për shkak të sasi së kufizuar të Megabajteve dhe fletë ngarkuese në E-prokurimi ka qenë i pamundur ti ngarkojmë të gjitha dokumentet në e-prokurim, vetë sistemi nuk na marr një numër të dokumenteve të cilat kemi dashur ti ngarkojmë. Ne kemi prezantuar listën e stafit të angazhuar në këtë projekt, e inxhinierëve duke i bashkangjitur edhe diplomat për secilin Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kërkesë të përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI 9.1. Disa prej dokumenteve të cilat nuk kemi mundur ti ngarkojmë në e-prokurim, Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit ofertave është dashur të kërkojnë informata sqaruese konform NENI 39.8 (RRUOP) dhe në pajtim me NENI 66 të LPP-së. Me këtë rast Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundërshtim NENI 39.8 (RRUOP) dhe NENI 66 të LPP-së, pa kërkuar informatat plotësues na ka refuzuar tenderi tonë, paneli shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatësisht te Dosjes se Tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), dokumentet qe përbejnë tenderin pika 19.1 (h) ne te cilën thuhet: Ju lutem qe gjatë përgatitjes dhe ngarkimit të ofertës tuaj në sistemin e e-prokurimit të keni parasysh dhe të ngarkoni, se bashku me ofertën tuaj, vetëm dokumentet të cilat kërkohen në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Me qëllim qe të mos ngarkohet sistemi pa nevoje me dokumente të cilat nuk kërkohen nga AK/MM në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, janë të panevojshme dhe pavlefshme derisa sa nuk kërkohen. Paneli shqyrtues gjatë shqyrtimit të dokumentacionit që ka pasur ne dispozicion konstaton se Grupi i Operatorëve Ekonomik ankues "TAULANT SHPK&STUDIO HAPSIRA SHPK " në sistemin e-prokurimit ka ngarkuar një mori të dokumenteve të cilat nuk janë kërkuar dhe të pa nevojshme, ndërsa dokumentet kyçe të kërkuara nuk i ka ngarkuara, dhe njëherit gjatë shqyrtimit të gjithë dokumentacionit të ofruar të gjithë Operatoreve Ekonomik pjesëmarrës të cilët kanë dorëzuar ofertat për ketë aktivitet të prokurimit nuk kanë paraqitur ndonjë shqetësim apo problem në ngarkim të dokumenteve që janë kërkuar, si pasojë e hapësirës së kufizuar në e-prokurim, andaj sqarimi se ngarkimi i dokumenteve në e- prokurim ka qenë i pa mundur për shkak të hapësirës së kufizuar është i pa qëndrueshëm,

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se AK nuk ka kërkuar informacione sqaruese konform nenit 72 i LPP-së - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, paragrafi 3. Ne te cilin thuhet se:-Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Bazuar në nenin 72 te LPP-se Autoriteti Kontraktues – komisioni vlerësues, gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka hasur në dëshmi qe e vërteton ekzistencën dokumentacion per të cilat në

bazë të këtij neni mund të kërkohen informata sqaruese, paneli shqyrtues konstaton se operatori ekonomik nuk i plotëson kërkesat e kërkuar me III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: dhe atë për: Kërkesa 9. OE duhet të caktoj një menaxher të projektit nga stafi profesional inxh. dipl. i Arkitekturës (min.8 vjet nga diplomimi). Nuk ka dorëzuar dëmshmit e kërkuara dokumentare: vendimi mbi caktimin e menaxherit te kontratës – kërkohet origjinali i vulosur dhe i nënshkruar nga OE kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar, referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë, objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone.

Kërkesa 10. Inxh. dipl. i Arkitekturës inxhinier eksperienca profesionale min. 5 vjet nga diplomimi- nuk ka dorëzuar dëmshmit e kërkuara dokumentare: Kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar, referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë, objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone.

Kërkesa 11. Inxh. dipl. i Arkitekturës inxhinier eksperienca profesionale min. 5 vjet nga diplomimi- nuk ka dorëzuar dëmshmit e kërkuara dokumentare: Kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar.

Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë, objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone.

Kërkesa 12. Inxh. dipl. i Ndërtimtarisë konstruktiv - eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit- nuk ka dorëzuar dëmshmit e kërkuara dokumentare : Kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar. Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone.

Kërkesa 13.Inxh. dipl. i Ndërtimtarisë konstruktiv - eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit- nuk ka dorëzuar dëmshmit e kërkuara dokumentare : Kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone.

Kërkesa 14. Inxh. dipl. i. Ndërtimtarisë hidroteknik , eksperienca profesionale min.5 vite nga diplomimi, përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit- nuk ka dorëzuar dëmshmit e kërkuara dokumentare: Kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar

Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë, objekte të

ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone.

15. Inxh. Dipl. i Makinerisë , eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën – projektuesit inxh. Makinerisë- nuk ka dorëzuar dëmshmit e kërkuara dokumentare: Kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar. Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë, objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone.

Kërkesa 17- Inxh. dipl. i Elektroteknikës, drejtimi kompjuterikë me telekomunikacion, eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit- nuk ka dorëzuar dëmshmit e kërkuara dokumentare

Kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar.

Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone.

Kërkesa 18- Inxh. dipl. i Gjeodezisë eksperienca profesionale min.5 vite Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë ,objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE ANKUES "TAULANT" SH.P.K. & "STUDIO HAPSIRA" SH.P.K" Prishtinë se AK-ja e ka eliminuar nga pjesëmarrja ne tender, për arsye se Diploma e Inxhinierit te elektroteknikes nuk është e drejtimit kompjuterik me telekomunikacion, paneli shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues e ka anuluar nga pjesëmarrja ne tender OE në fjalë, për arsye se Diploma e Inxhinierit te elektroteknikes nuk është e drejtimit kompjuterik me telekomunikacion. Kjo nuk qëndron sepse z. Vegim Hoti ka mbaruar kursin e plote të Fakultetit të INXHINIERISË MEKANIKE DHE ELEKTRIKE TË UNIVERSITETIT TE TIRANËS në degën ELEKTRONIKE me datën 14. 01. 1987 dhe i jepet titulli: INXHINIER ELEKTROTEKNIKE, mirëpo z. Vegim Hoti nuk e plotëson kriterin te: Kërkesa 16- Inxh. dipl. i Elektroteknikes drejtimi energjetike, eksperienca profesionale dhe përvojë pune në pesë (5) vitet e fundit në detyrën projektuesit-inxh. Elektrikes, pasi që nuk ka dorëzuar dëmshmit e kërkuara dokumentare: Kontratë valide (ATK) ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar dhe e noterizuar, Referenca pozitive për projektet e kryera ne fushën e projektimit ndërtime të larta dhe te ultë, objekte të ndryshme administrative, publike, ndërtim, renovime, kanalizimi dhe ujësjellës, ndriçimi i jashtëm, poligone.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Përveç disa devijimeve të cilat Paneli shqyrtues i konsideron devijim të vogël në harmoni me nenin 59 paragrafi 4 pika (ii) për shkak se ky fakt nuk mund të shkaktojë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit dhe nuk ndikon realisht në realizimin e një kontratë të tillë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Ministria e Mbrojtjes";

1x1 OE "Arhiko Ing O.P; & Al-Group"SH.P.K-Prishtinë;

1x1 OE "Taulant"SH.P.K, & "Studio Hapsira"SH.P.K-Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.